



OLIMPIADA KOMBËTARE E HISTORISË
NË ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Faza e dytë

Klasa 11

27 janar 2024

Udhëzime për nxënësin:

- Olimpiada fillon në orën 10.00 dhe mbaron në orën 13.00.
- Testi përmban 5 pyetje.
- Për secilën pyetje është lënë hapësira e nevojshme për të shkruar përgjigjen.

Për përdorim nga komisioni i vlerësimit

Pyetja	1	2	3	4	5
		6 pikë	12 pikë	10 pikë	8 pikë
Pikët e fituara					

Totali i pikëve

KOMISIONI I VLERËSIMIT

1.....Anëtar

2.....Anëtar

1. Konferenca e Pezës dhe ajo e Mukjes përbëjnë ngjarje kulmore gjatë Luftës së Dytë Botërore në Shqipëri.

a) Evidentoni dy të përbashkëta mes këtyre ngjarjeve historike.

2 pikë

- Qëllimi ishte bashkimi sa më i gjerë i forcave antifashiste në luftë për çlirimin e vendit.
- Pjesëmarrja ishte nga një spektër i gjerë bindjesh politike.
- Në përfundim të tyre u krijuan organizma të përbashkët gjithëpërfshirës për organizimin e luftës kundër pushtuesit.
- Theksohej angazhimi për vendosjen e një sistemi demokratik qeverisjeje.
- Forma përfundimtare e qeverisjes u ra dakord të përcaktohej pas luftës.
- Vendet e mbajtjes ishin në Shqipërinë e Mesme dhe relativisht pranë njëra-tjetrës.
- Etj.

b) Evidentoni dy të veçanta mes këtyre ngjarjeve historike.

2 pikë

- Konteksti i përgjithshëm i luftës ishte i ndryshëm: Konferenca e Pezës u mbajt në një periudhë kur kontrolli italian ishte i plotë mbi Shqipërinë, ndërsa ajo e Mukjes u mbajt në një moment kur ky pushtim ishte lëkundur shumë pas firmosjes së armëpushimit mes Italisë dhe Aleatëve. Edhe në frontet e tjera të luftës situata kishte evoluar qartësisht në favor të Aleatëve.
- Zbatimi i vendimeve pati fat të ndryshëm, ato të Konferencës së Pezës në u zbatuan në tërësinë e tyre, ndërsa ato të Mukjes u hodhën poshtë shumë shpejt dhe nuk gjetën zbatim në praktikë.
- Në konferencën e Pezës morën pjesë nacionalistë mbi baza individuale ndërsa në Mukje pala nacionaliste u përfaqësua në nivel organizate.
- Në organizimin e Konferencës së Mukjes rol të rëndësishëm patën misionet aleate që vepronin në Shqipëri, ndërsa në atë të Pezës një rol i tillë mungonte.
- Konferenca e Pezës nuk e përmendi elementin e trojeve shqiptare jashtë kufijve politikë të njohur ndërkombëtarisht të shtetit shqiptar ndërsa në Mukje u afirmua angazhimi për bashkim pas lufte.
- Etj.

c) Shpjegoni ndikimin e këtyre konferencave në ngjarjet që pasuan.

2 pikë

Nëse në periudhën pas Konferencës së Pezës, pati njëfarë bashkëpunimi mes forcave nacionaliste dhe atyre komuniste në luftën kundër pushtuesit, pas Mukjes ky bashkëpunim jo vetëm u shua tërësisht por nisën të evidentohen element të rëndësishëm të një lufte civile mes krahut komunist dhe atij nacionalist. Përfundimi i përplasjeve ndërshqiptare ishte instalimi i regjimit komunist pas tërheqjes së forcave pushtuese gjermane.

2. "Enver Hoxha ndërtonte taktikat e thurte rrjetat. Kur e shikonte të udhës, lëshonte pak pe, bënte sondazhe, maste pulset e pastaj i fuste peshqit në rrjetë... Ai vetë ishte autor i të gjithave. Ai nuk mund të lejonte që "pranvera e shkurtër" e Shqipërisë të viteve '70-'71 të kthehej në furtunë për pushtetin".

Agim Mero, ish-sekretar i Komitetit Qendror të Bashkimit të Rinisë, gazeta Panorama 19 gusht 2013

- a) Cili kontekst ndërkombëtar i lidhur me Shqipërinë shërbeu si sfond për fushatën e goditjeve brenda strukturave të PPSH në vitet 1973–1975. **2 pikë**

Pas prishjes me Bashkimin Sovjetik dhe vendet e tjera të bllokut lindor në vitet 1960-1961 dhe pas daljes edhe zyrtare nga Traktati i Varshavës në 1968, Shqipëria u orientua nga Kina në funksion të marrëdhënieve politike, ekonomike dhe ushtarake. Për disa vite, Kina u kthye në vendin e vetëm që furnizonte me ndihma apo kredi Shqipërinë.

Fillimi i viteve '70 solli një ftohje të marrëdhënieve, deri atëherë të ngushta, mes Kinës dhe Shqipërisë. Përmirësimi i marrëdhënieve të Kinës me SHBA të kulmuara më vizitën e Niksonit në Kinë në shkurt 1972, u përçoll me tronditje në qarqet më të larta të pushtetit në Shqipëri. Ato iu kundërvunë kësaj lëvizjeje diplomatike në terma ideologjike dhe kjo solli një çarje dhe divergim gjithnjë e më të madh mes interesave të Kinës dhe të Shqipërisë. Edhe orientimi i dhënë nga Kina për një bashkëpunim më të madh me Jugosllavinë dhe Rumaninë e shtoi shqetësimin në udhëheqjen shqiptare dhe posaçërisht tek Enver Hoxha lidhur me implikimet e qëndrimeve të reja të Kinës. Këto konjunktura të marrëdhënieve ndërkombëtare nisën të pasqyrohen edhe në gjendjen e brendshme, sidomos ekonomike, duke sjellë edhe një rritje tensioni në skenën politike shqiptare.

- b) Cila ishte ngjarja artistike që u përdor si pretekst për goditjen e "grupit armiqësor" në art dhe kulturë dhe cilët ishin përfaqësuesit kryesorë partiakë që patën pasojat për shkak të kësaj goditjeje? **2 pikë**

Si pretekst për nisjen e goditjeve politike në fushën e artit dhe kulturës në përgjithësi shërbeu Festivali i 11 i Këngës në RTSH në dhjetor 1972.

Personazhet politike kryesore që u goditën në art dhe kulturë ishin Todi Lubonja dhe Fadil Paçrami.

- c) Shpjegoni drejtimet kryesore të sulmit të Enver Hoxhës në fushën e artit dhe kulturës. **4 pikë**

Drejtimet kryesore të sulmeve ishin kundër:

- tendencave liberale dhe moderniste në art e kulturë.
- shfaqjeve të huaja në sjellje, veshje etj.
- ndikimeve të kulturës perëndimore në jetën dhe shoqërinë shqiptare.

- d) Gjykoni mbi ngjarjet e kësaj periudhe në fusha të tjera të jetës së vendit dhe pasojat për të ardhmen. **4 pikë**

Goditjet në art e kulturë ishin preludi i një fushate shumë më të gjerë spastrimi që përfshiu praktikisht gjithë jetën e vendit, ekonominë dhe mbrojtjen. U dënuan figura të rëndësishme të sektorit ekonomik të cilëve iu faturuan vështirësitë që ishin evidentuar në gjendjen e tregut e standardit të jetesës, nën petkun e "sabotimeve" të ekonomisë.

Po kështu, edhe në fushën e mbrojtjes u zhvillua një fushatë e gjerë spastrimi si masë preventive e ndonjë lëvizje (me shume mundësi e imagjinuar) nga ana e ushtrisë, nën justifikimin e tentativave për "sabotim" të vijës së partisë në ushtri dhe përpjekjeve për përmbysje të qeverisjes.

Pasojat e këtyre fushatave spastruese i gjejmë në rritjen e ndjenjës së terrorit e frikës në radhët e popullsisë në përgjithësi dhe kuadrove partiakë e shtetërore në veçanti, shtimit të problemeve ekonomike me kalimin në regjimin e "mbështetjes në forcat e veta", mungesën e investimeve me fonde të huaja (kineze) etj.

3. Ahmet Zogu në situatën e pastabilizuar pas shtypjes së Revolucionit të vitit 1924, duke njohur aspiratat e shqiptarëve për një regjim republikan dhe i bindur se edhe Evropa e përparuar do të mirëpriste gjithashtu një regjim të tillë, vendosi të shpallte Republikën. Republika e shpallur ishte e tipit presidencial. Presidenti ishte kreu i shtetit dhe kryetar i ekzekutivit, pra kryente edhe funksionin e Kryeministrit.

a) Analizoni funksionet që kryente Presidenti i Republikës.

5 pikë

- Presidenti ishte kreu i shtetit dhe kryetar i ekzekutivit, pra kryente edhe funksionin e Kryeministrit
- Presidenti vepronte si kryetar i shtetit dhe i qeverisë.
- Kontrollonte kabinetin, emëronte dhe pushonte çdo ministër.
- Kontrollonte Senatin, në të cilin kishte të drejtë të caktonte gjashtë anëtar, ndërsa pjesa tjetër zgjidhej prej Asamblesë.
- Komandonte forcat e armatosura dhe gëzonte të drejtën e emërimit dhe të pushimit të të gjithë oficerëve të lartë.
- Gëzonte të drejtën supreme të nismës për ndryshimin e Kushtetutës dhe vetëm ai kishte të drejtë të propozonte ligje për rritjen e buxhetit dhe për mënyrën e shpërndarjes.
- Kishte të drejtën e vetos mbi ligjet e ndryshme që vinin për miratim.
- Mund të shpërndante parlamentin dhe të caktonte zgjedhje të reja në çdo kohë.
- Etj.

b) Në 1 shtator 1928, ditën që u miratua Statuti i ri nga Asambleja Kushtetuese, u shpall Monarkia shqiptare dhe Ahmet Zogu mbret i shqiptarëve, me emrin Zogu I.

Analizoni funksionet që statuti i monarkisë i njihte Mbretit Zog.

5 pikë

- Mbreti drejtonte drejtpërdrejtë politikën e brendshme dhe të jashtme.
- Mbreti kishte të drejtën të lidhte traktate miqësie dhe aleance dhe traktate të tjera të karakterit politik dhe ushtarak pa qenë nevoja të miratoheshin nga parlamenti.
- Ishte kryekomandant i forcave të armatosura dhe kishte të drejtën të shpallte luftë.
- Emëronte dhe shkarkonte kryeministrin, ministrat dhe funksionarë të lartë të administratës.
- Kontrollonte veprimtarinë e anëtarëve të qeverisë dhe funksionarëve të lartë shtetëror dhe për shkelje i dërgonte në Gjykatën e Lartë të Shtetit.
- Ndërmerre nisma ligjvënëse dhe nxirrte dekrete normative.
- Zotëronte të drejtën e faljes dhe atë të lehtësimit të dënimeve penale.
- Etj.

4. "Pse nuk ka kritikë konkrete për punën, për shokë ministra e anëtarë të Komitetit Qendror si dhe kuadro të tjerë kryesorë?"
"A ka raste që njerëz që kanë kritikuar shokët me përgjegjësi të jenë persekutuar?"
"Si është çështja e kultit të individit te ne dhe ajo në Byronë Politike?"
"Ulja e pagesës së punonjësve si mund të përputhet me parullën e Partisë për ngritjen e nivelit të jetesës së popullit?"

Pyetje nga delegatët e Konferencës së Tiranës së vitit 1956

- a) Shpjegoni kontekstin ndërkombëtar kur u mbledh kjo konferencë. **2 pikë**

Konteksti ndërkombëtar është shumë i rëndësishëm në interpretimin e ngjarjeve të ndodhura gjatë zhvillimit të Konferencës së Tiranës në prill të vitit 1956. Ngjarja kryesore ishte Kongresi 20 i PK të BS që u mbajt në shkurt 1956, pra pak kohë para konferencës. Tezat, vendimet dhe sidomos, i ashtuquajturit "raporti sekret" i mbajtur nga Hrushovi sollën tronditje shumë të forta në gjirin e bllokut lindor deri në nivelet më të larta të qeverisjes pasi po përvijoheshin shumë ndryshime të rëndësishme të vijës politike të ndjekur deri atëherë në BS dhe, rrjedhimisht, edhe në vendet e tjera satelite të Moskës në Evropën Lindore.

- b) Argumentoni përse zhvillimet e konferencës sollën një shqetësim të madh në udhëheqjen e lartë të PPSH. **4 pikë**

Shqetësimet e udhëheqjes së lartë të PPSH dhe personalisht të Enver Hoxhës rridhnin nga fakti që një pjesë e mirë e delegatëve në konferencë kërkonin me insistim që të flitej dhe reflektohej lidhur me tezat e Kongresit 20 për shumë probleme që ata identifikonin në vijën dhe politikën e zbatuara nga ana e udhëheqjes komuniste shqiptare si: probleme me kultin e individit, favorizimet dhe privilegjet e udhëheqjes, mosrehabilitimi i figurave të ndryshme të dënuara më herët, gjendjen e keqe ekonomike dhe zgjatjen e sistemit të triskëtimit, zbutjen e luftës ekstreme të klasave etj. Të gjitha këto çështje, nëse do të trajtoheshin me përgjegjësi, rrezikonin seriozisht pozitën udhëheqëse të Enver Hoxhës dhe Byrosë Politike në tërësi, pasi ata ishin indirekt edhe targeti i pyetjeve dhe kritikave nga ana e pjesëmarrësve në konferencë.

- c) Arsyetoni pse konferenca u konsiderua si një "rast i humbur". **2 pikë**

Nëse problemet e ngritura në konferencë do të ishin marrë në konsideratë, do të kishte ndryshime shumë të rëndësishme në vijën e PPSH dhe politikën shtetërore që mbështeteshin mbi këtë vijë. Do të kishte pasur një frymë më liberale në politikë, shoqëri dhe ekonomi, një politikë më pak ekstremiste për sa i përket luftës së klasave, një ndryshim edhe në gjirin e udhëheqjes drejt elementeve më pak radikalë dhe më të hapur, një frymë më e hapur bashkëpunimi edhe në arenën ndërkombëtare. Pra përgjithësisht, klima politike, shoqërore, artistike, ekonomike do të ecte në shina të tjera.

Reagimi ekstrem i Enver Hoxhës dhe udhëheqjes në përgjithësi dhe shuarja e zërave kritike në konferencë, shënuan fundin e çdo përpjekje për reformim nga brenda të sistemit politiko-ekonomik të Shqipërisë.

5. Gjatë Luftës I Botërore disa politikanë (Lloyd Xhorxh dhe Udro Uillson) filluan të diskutojnë për rrugët që duhet të ndiqnin për të shmangur një konflikt tjetër ndërkombëtar. U hodhën ide për krijimin e një organizate me bazë të gjerë që do të trajtonte një gamë të gjerë problemesh ndërkombëtare dhe do të mblidhej për të zgjidhur mosmarrëveshjet dhe krizat. U krijua kështu Lidhja e Kombeve.

a) Cili ishte qëllimi kryesor i Lidhjes së Kombeve?

2 pikë

Qëllimi kryesor ishte ruajtja e paqes botërore dhe përpjekja për të promovuar bashkëpunimin ndërkombëtar në shkallë të gjerë ekonomike e sociale, duke përfshirë çarmatimin.

b) Organet kryesore të Lidhjes ishin: Asambleja, Këshilli dhe Sekretariati. Cilat ishin funksionet e secilit organ?

6 pikë

Asambleja mblidhej një herë në vit, Çdo anëtar kishte të drejtën e një vote. Shqyrtonte çështje të politikës së përgjithshme. Kontrollonte buxhetin e Lidhjes. Pranonte anëtarët e rinj dhe zgjidhte anëtarët e përkohshëm të Këshillit.

Këshilli ishte organi kryesor i Lidhjes. Mblidhej katër ose pesë herë në vit dhe në kohë krizash. Kishte anëtarët e përhershëm dhe të përkohshëm

Sekretariati ishte organ administrativ i Lidhjes. Kryente të gjitha punët administrative dhe financiare. Organizonte konferenca, shpërndante agjenda, monitoronte buxhetin, publikonte raportet.

c) Analizoni qëndrimin e SHBA, Gjermanisë dhe BRSS ndaj Lidhjes së Kombeve.

6 pikë

SHBA

Edhe pse presidenti Uillson ishte një nga ideatorët e Lidhjes së Kombeve, SHBA refuzoi t'i bashkohej Lidhjes, sepse shumica në Senatin amerikan mendonin se anëtarësimi do t'i përfshinte amerikanët në të ardhmen në luftë dhe mosmarrëveshje. Mospjesëmarrja e SHBA ishte një mangësi e madhe e Lidhjes, duke e privuar atë nga shteti më i fuqishëm, më me influencë dhe më i pasur në botë.

Gjermania

Gjermania nuk u lejua të anëtarësohej derisa ajo të tregonte synime paqësore. Kjo krijoi efektin e gabuar se Lidhja s'ishte gjë tjetër veç një klub i shteteve fituese i lidhur me Traktatin e Versajës. Gjermania u lejua të anëtarësohej në 1926 dhe u bë anëtar i përhershëm i Këshillit. Por në 1933 me ardhjen në pushtet të Adolf Hitlerit një nga aktet e para të firmosura ishte largimi nga Lidhja.

Bashkimi Sovjetik

BS nuk u ftua t'i bashkohej Lidhjes kryesisht për arsye ideologjike pasi ishte vend komunist i përkushtuar për përmbysjen e kapitalizmit. As vet BS nuk kishte kërkuar t'i bashkohej kësaj Lidhje, pasi disa nga shtetet (Britania dhe Franca) kishin ndihmuar në mënyrë aktive kundër Revolucionit gjatë Luftës Civile në Rusi (1918-1921). Në fund të viteve '20 kishte një tolerancë nga të dy palët dhe në 1934 iu bashkua Lidhjes, për t'u dëbuar 1939 pas pushtimit të Finlandës.